



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

Nr. 49, datë 26.03.2016

Për

Miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat sha"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" (neni 54, germa d), Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; Statutit të Ndërkomunale Bushat sha, neni 13, neni 30 germa "c", VKK Nr.13.Prot datë 29.03.2016 "Për miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat" sh.a, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Aksionarëve, Keshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 26.03.2016, me shumicë të cilësuar votash, pas përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshimin në VKK Nr.13.Prot datë 29.03.2016 "Për miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat" sh.a, ku afati i emërimit të Këshillit Mbikqyrës:
  - Ishte: 5 vete.
  - Bëhet: 3 vete.
2. Të emërojë si Kryetar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha, z.Robert Kreçi, me afat 3 (tre) vjeçar. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
3. Të emërojë si anëtar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha, z.Nikoll Markaj me afat 3 (tre) vjeçar. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
4. Të emërojë si anëtar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha, z. Vladimir Bezhani. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
5. Anëtarët e mëparshëm, të cilëve u ka mbaruar afati, hiqen nga Këshilli Mbikqyrës.
6. Të hiqet adresa Bushat, Bushat, Zyrat e Komunës, dhe të vendoset adresa Bushat, Njësia Administrative Bushat, Lagjia Qendër, Zona Kadastrale 1329, Nr pasurisë 552, ndërtesë 3 katëshe, kat 1.
7. Sipas Ligjit nr.115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", në të gjithë vendet ku është shprehur Komuna Bushat do të bëhet Bashkia Vau Dejës.

Adresa: Qyteti Vau-Dejës, Rruga "Qafa e Gurit", Tel & Fax:026120006, Email:bashkiavaudejës@hotmail.com

8. Ndryshohet objekti i veprimtarisë nga Pastrimi dhe gjelberimi në teritorin e Komunes Bushat, Mbledhja, sistemimi dhe riciklimi i mbetjeve urbane të Qarkut të Shkodrës dhe pjesërisht të Qarkut Lezhë, Kryerja e shërbimeve në dobi të komunitetit, shërnime keto që janë për tu kryer nga ana e pushtetit vendor në Administrimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane të Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

10. U shpall sot me datë 26/03/2016.

SEKRETARI  
Gentian NDOJ



KRYETARI  
Martin MARKU

Adresa: Qyteti Vau-Dejës, Rruga "Qafa e Gurit", Tel & Fax:026120006, Email:bashkiavaudejës@hotmail.com

KERKESE

DREJTUAR: Qendres Kombetare te Rregjistrimit

Une z. Albert Markolaj me cilesine e administratorit te shoqeris NDERKOMUNALE BUSHAT SHA me NIPT K87108002A kerkoj qe te behen ndryshimet si me poshte:

1. heqjen e adreses Bushat, Bushat, Zyrat e Komunës.
2. shtimin e adreses Bushat, Njesia Administrative Bushat, Lagjia Qender, Zona Kadastrale 1329, Nr pasurise 552, ndertesë 3 kateshe, kat 1

Administratori

Albert Markolaj

